



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 207, Datë 11.12.2020

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2020.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017 i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE) në mbledhjen e tij të datës 11.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr.131/5 prot, datë 09.12.2020 nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin Nëntor 2020,

Konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën e saj nr. 10979 Prot, datë 02.12.2020, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike për muajin Nëntor 2020, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- FTL sh.a. ka realizuar katër procedura për blerje të energjisë elektrike, respektivisht për plotësimin e nevojave të "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. dhe "Furnizuesit të Shërbimit Universal" sh.a..
- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., Kostot Administrative të Furnizuesit të mundësisë së fundit për vitin 2020, janë vlerësuar sa ato të vitit 2019.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019, “Mbi lënien në fuqi të vendimit Nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020”, është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin Nr. 199, datë 12.12.2019, të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE Nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020”, është 1.5 lekë/kWh.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a. si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Nëntor 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Nëntor 2020

Nëntor 2020		Njësia	Aplikimi FSHU sh.a.	Përlogaritjet e ERE
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	7.072	7.072
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.21</u>	<u>0.21</u>
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	7.28	7.28
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	11.32	11.32

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionit të përcjellë nga FTL sh.a. si dhe vlerësimeve të ERE sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **Nëntor 2020**, të jetë **11.32 Lekë/kWh**.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 11.32 Lekë/kWh, për muajin Nëntor 2020.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI